



raporti i **MONITORIMIT** PËR PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Raporti numër 3

(periudha e raportimit:
shkurt – prill 2019)

Shkup, 2019

АКЦИЈА ЗА ПОГОЛЕМА
транспарентност,
отчетност и ефективност



на **СУДСКИОТ**
СОВЕТ НА РМ



Институт за човекови права

Projekti:

Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM

Implementues:

Instituti për të Drejtat e Njeriut



Ky publikim u përgatit në kuadër të projektit "Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM", i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetje të Ambasadës Britanike në Shkup. Opinionet dhe qëndrimet e prezantuara në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë çdoherë opinionet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.

Hyrje

Raporti i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor, për periudhën kohore shkurt – prill të vitit 2019 u hartua në kuadër të projektit “Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RMV¹ për matjen e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të Këshillit Gjyqësor.

Instituti për të Drejtat e Njeriut ka për synim që në mënyrë më të lehtë dhe gjithëpërfshirëse ta vlerësoj transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e punës së Këshillit Gjyqësor përmes pjesëmarrjes në mbledhje publike, monitorimit të ueb-faqes së Këshillit Gjyqësor dhe përmes qasjes së lirë deri te informatat me karakter publik.

TRANSPARENCA NË PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR

Transparenca përmes mbledhjeve të hapura të Këshillit Gjyqësor

	Shkurt	Mars	Prill
Mbledhje të mbajtura	4	3	3

Llojet e publikimeve

Lloji i publikimit	Në kohë	I plotë	Shënim
Komunikatë	Në kohë	Pjesërisht e plotë	Komunikatat e mbledhjeve të mbajtura janë titulluar si “Komunikatë për mbledhje...” ose “Komunikatë nga mbledhja...” me numër të mbledhjes. Theksohen pikat e mirat-uara. Si ndryshim pozitiv është ajo se disa pika sqarohen më detajisht për dallim nga e kaluara.

1 <http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=357>

Lloji i publikimit	Në kohë	I plotë	Shënim
Vendime	Pjesërisht në kohë	Të pjeshme	<p>Në këtë periudhë është publikuar: Vendimi për përcaktimin e numrit të përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidhë gjyqtari në nivel mujor në gjykatat themelore, të apelit në Gjykatën Administrative, në Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) për vitin 2019.</p> <p>Sa i përket transparencës vendimet e votimit nga mbledhjet e mbyllura deri më tani nuk janë publikuar edhe pse një gjë e këtillë është detyrim ligjor.</p>
Procesverbale	Pjesërisht në kohë	Të plota	<p>Procesverbalet e mbledhjeve publikohen në ueb-faqe, obligim ky i paraparë me ligj. Publikimi i procesverbaleve në aspektin kohor ka të bëjë me miratimin në mbledhjen e KGJ të RMV, ndërsa kjo mund të ndodhë edhe disa javë më vonë nga mbajtja e mbledhjes të cilës i referohet procesverbali.</p>
Raporte	Në kohë	Të plota	<p>Raportet tremujore për punën e gjykatave publikohen rregullisht. Raportin e punës Këshilli Gjyqësor e miratoi në afatin e parashikuar me ligj dhe ia dërgoi Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.</p>

Lloji i publikimit	Në kohë	I plotë	Shënim
Останати документи	Pjesërisht në kohë	Të plota	U ndryshua dhe plotësua Rregullorja për shtesa në pagë, lartësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullorja për shtesa në pagë, lartësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për gjyqtarët në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Rregullorja për shtesa në pagë, lartësia e tyre dhe mënyra e përcaktimit për nëpunësit gjyqësorë. Këto Rregullore shkaktojnë një sërë reagimesh në publik, meqë Këshilli Gjyqësor fillimisht mori vendim për rritjen e pagave, ndërsa më vonë i ndryshoi rregulloret. Këshilli Gjyqësor theksoi se vendimet u miratuan konform Ligjit për pagat e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor, në mbledhjen e mbajtur, e shqyrtoi edhe Raportin për kontrollin e bërë mbi funksionalitetin e sistemit informatikë dhe për monitorimin e zbatimit të dispozitave të Rregullores gjyqësore për Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup, Gjykatën e Apelit Shkup dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, KGJ i RMV mori vendim unanim mbledhja të jetë e mbyllur meqë në raport mund të ketë të dhëna të cilat mund të ndikojnë mbi reputacionin dhe integritetin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave dhe prandaj u votua pika që mbledhja të jetë e mbyllur për publikun.

Këshilli Gjyqësor në këtë periudhë mori Vendim me të cilin u përcaktua numri i vendeve vakante të gjyqtarëve në gjykatat themelore edhe atë 55 (pesëdhjetë e pesë) për gjeneratën e VII-të të kandidatëve për gjyqtarë në Akademinë për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.

Këshilli Gjyqësor, nga aspekti formal-juridik, e përmirësoi transparencën gjatë punës së tij e që pjesërisht është pasojë e ndryshimeve ligjore të cilat parashikojnë detyrim për publikimin e dokumenteve të Këshillit Gjyqësor. Megjithatë, nevojitet transparencë thelbësore dhe justifikim gjatë miratimit të vendimeve. Nga ana tjetër, nevojitet të përmirësohet portali gjyqësor sud.mk meqë në pjesën e Këshillit Gjyqësor vendimet e miratuara dhe ngjashëm nuk prezantohen në mënyrë të qartë dhe kronologjike, por fillon nga dokumenti më i vjetër, ndërsa dokumentet e reja janë në faqen e fundit.

Njoftim për publikun e gjerë

Për aktivitetet e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Gjyqësor mund të kuptohet nga komunikatat të cilat publikohen në ueb-faqe. Në periudhën e kaluar Këshilli Gjyqësor më shpesh publikon informacione për aktivitetet rrjedhëse, ndërsa publikoi komunikata dhe reagime në lidhje me deklarata të cilat ndikojnë mbi integritetin e gjyqtarëve. Kryetari dhe zëvendëskryetari i sapo zgjedhur i Këshillit Gjyqësor dhanë deklarata për mediat menjëherë pas zgjedhjes së tyre. Puna e Këshillit Gjyqësor dhe veçanërisht komunikimi i Kryetarit të Këshillit Gjyqësor me publikun, në periudhën e ardhshme do të vlerësohen vazhdimisht nga IDNJ.

EFEKTIVITETI NË PUNËN E KËSHILLIT GJYQËSOR

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave: shkurt – prill të vitit 2019

U mor Vendimi për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e kryetarit të: Gjykatës Themelore Manastir, Gjykatës Themelore Veles, Gjykatës Themelore Dellçevë, Gjykatës Themelore Kavadar, Gjykatës Themelore Kërçovë, Gjykatës Themelore Kriva Pallankë, Gjykatës Themelore Negotinë, Gjykatës Themelore Prilep, Gjykatës Themelore Shkup 2 – Shkup, Gjykatës Themelore Shtip.

Këshilli Gjyqësor mori vendim për caktimin e kryetarëve UD në 10 gjykata, kështu që i caktoi kryetarët e deritanishëm, të cilëve iu skadon mandati, për kryetarë UD. Shkaku për këtë veprim ishin zgjedhjet presidenciale në shtet, ndërsa në këtë periudhë kohore KSHPK rekomandon të mos bëhet zgjedhja e bartësve të funksioneve publike. Pikërisht për këtë shkak, caktimi i këtyre 10 kryetarëve UD të gjykatave u realizua në periudhën midis dy rretheve të zgjedhjeve presidenciale.

U mor vendim për shpalljen e Konkursit për zgjedhjen e 6 (gjashtë) gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shkup, si vijon:

3 (tre) gjyqtarë për fushën penale;

2 (dy) gjyqtarë për fushën civile dhe

1 (një) gjyqtarë për konteste tregtare

Akoma nuk janë zgjedhur gjyqtarët e Gjykatës Administrative për të cilët Këshilli Gjyqësor shpalli konkurs që në muajin janar të vitit 2019, me kriteret të cilat ishin në fuqi para miratimit të ndryshimeve të fundit të Ligjit për gjykata (për gjyqtarë në Gjykatën Administrative mund të konkurrojnë edhe persona të cilët kanë më së paku pesë vjet stazh në punë juridike në organ shtetëror, me rezultate të konfirmuara në punë, ndërsa me ndryshimet e fundit ligjore përcaktohet që për gjyqtarë të Gjykatës Administrative mund të zgjidhet vetëm gjyqtari i cili ka përvojë pune prej më së paku katër vjet pa ndërprerje të stazhit gjyqësor si gjyqtar në gjykatën themelore deri në momentin e aplikimit për zgjedhje i cili nga organi kompetent është vlerësuar me notë pozitive.

Zgjedhja e kryetarëve dhe gjyqtarëve të gjykatave do të bëhet në periudhën e ardhshme edhe atë sipas kriterëve të deritanishme (për konkurset të cilët janë shpallur para hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore).

Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit Gjyqësor

Më datë 25 prill të vitit 2019, Këshilli Gjyqësor e zgjodhi Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Këshillit Gjyqësor.

Për Kryetar u zgjodh gjyqtari Kiro Zdravev (me 12 vota PËR – nga 12 anëtarë të pranishëm)

Për Zëvendëskryetar u zgjodh Selim Ademi (me 11 vota PËR dhe 1 votë KUNDËR – nga 12 anëtarë të pranishëm)

Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor

Këshilli Gjyqësor e miratoi **Raportin vjetor për punë për vitin 2018** dhe ia dërgoi Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Raporti përmban informata për numrin e gjyqtarëve, kryetarëve të zgjedhur të gjykatave dhe të gjyqtarëve-porotë, numrin e gjyqtarëve, kryetarëve të shkarkuar të gjykatave dhe të gjyqtarëve-porotë, procedurat e përcaktimit të përgjegjesisë së gjyqtarëve, informata për bashkëpunimin me institucione të tjera, gjendjen kadrovike në sistemin gjyqësor etj.

Së këtejmi, në mbledhjen e Këshillit Gjyqësor në të cilin u miratua Raporti vjetor, anëtarët ranë dakord se Raporti duhet të përmbaj më shumë të dhëna në pjesën e procedurave për përcaktimin e përgjegjesisë së gjyqtarit, përkatësisht të arsyetohet mirë në cilën fazë është secila nga procedurat individuale. **Sipas kësaj, Raporti për herë të parë përmban edhe të dhëna të detajuara për procedurat e përgjegjesisë së gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës (baza, faza në të cilën gjenden, veprimet e ndërmarra nga Këshilli Gjyqësor dhe ngjashëm). Megjithatë, mund të vërehet se të dhëna të këtyra të detajuara mungojnë në procedurat për përcaktimin e përgjegjesisë të cilat zhvillohen kundër gjyqtarëve të cilët kanë marrë vendime për lëndë gjyqësore të cilat zhvillohen sipas akuzës së aprovuar nga Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale të ndërlidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve.**

Në përputhje me ndryshimet ligjore **Raporti duhet të përmbaj edhe të dhëna për shkallën e realizimit të Programit vjetor për punën e Këshillit sipas pozicioneve.**

Raporti i ardhshëm vjetor i Këshillit duhet ta përfshijë përmbushjen e Programit vjetor dhe Plan Veprimin për vitin 2019.

Këshilli Gjyqësor, në periudhën e ardhshme, duhet të fokusohet mbi përmbushjen e Programit vjetor për punë i cili e përfshin edhe Plan Veprimin për përmbushjen e minimumit të prioriteteve si vijojnë:

- Monitorimi dhe zbatimi i akteve të reja ligjore në lidhje me punën e Këshillit;
- Plani për monitorimin e vazhdueshëm të punës së gjykatave;
- Rekomandime për gjykatat dhe sigurim të bashkëpunimit më të madh me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave;
- Përmirësimi i reputacionit të Këshillit Gjyqësor;
- Organizimi i ngjarjeve për prezantimin e punës së gjykatave dhe të Këshillit;
- Organizimi i debateve për sfidat me të cilat ballafaqohet gjyqësori;
- Mbrojtja e gjyqtarëve nga presionet dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqësorit;
- Realizimi i pavarësisë më të madhe financiare të Këshillit;
- Vlerësimi i nevojave kadrovike të gjyqtarëve dhe përforcimi i resurseve njerëzore;
- Avancimi i bashkëpunimit me Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë;
- Sigurimi i resurseve përkatëse, hapësina, teknike dhe njerëzore dhe punësimi i ekspertëve për statistika dhe vlerësime;
- Respektimi i parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RMV;
- Ndjekja e rekomandimeve dhe masave të propozuara nga analizat e raporteve tremujore dhe vjetore për punën e gjykatave.²

Instituti për të Drejtat e Njeriut me ndihmën e ekspertit të jashtëm e ndihmoi procesin e hartimit të Planit strategjik të Këshillit Gjyqësor për periudhën kohore 2020-2025. Plani strategjik përfshinë udhëzime dhe parime për avancimin e punës së Këshillit të cilat në të ardhmen do të jenë objekt të monitorimit nga ana e Institutit për të Drejtat e Njeriut. Pas finalizimit të Strategjisë, Këshilli Gjyqësor duhet ta publikoj dokumentin në ueb-faqen e tij.

² Raporti vjetor dhe Plan Veprimi për punën e Këshillit Gjyqësor për vitin 2019

Këshilli Gjyqësor i shqyrtoi dhe miratoi raportet vjetore për punën e gjykatave

Sa i përket prurjeve të përgjithshme të lëndëve për vitin 2018 në të gjitha gjykatat e shtetit u konstatua se janë proceduar dhe është reduktuar prurja vjetore për 7.767 lëndë, **së këtejmi si gjykata joazhurne u vlerësuan 13 gjykata në gjithë territorin e shtetit**. Si shkak kryesor për mosprocedimin e të gjitha prurjeve të lëndëve është mungesa e gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionistë nëpër gjykata, përkatësisht nuk është plotësuar numri në përputhje me sistematizimin. Megjithatë, ka gjykata të cilat nuk i kanë proceduar të gjitha lëndët në vitin 2018 dhe së këtejmi nuk kanë dhënë ndonjë arsyetim të qartë në raportet e tyre për këtë situatë, e këtillë është Gjykata Themelore në Ohër dhe Gjykata Themelore në Koçan.

Sa i përket gjendjes me lëndët më të vjetra se tre vjet u theksua se numri i tyre është reduktuar për plot 50% në vitin 2018, lëndët më të vjetra se 7 vjet janë reduktuar për 31% dhe numri i lëndëve më të vjetra se 10 vjet janë reduktuar për 18%.

Përcaktimi i përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës

Këshilli i shqyrtoi edhe pikat e rendit të ditës të cilat ishin të mbyllura për publikun – për procedurat e përcaktimit të përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës.

Në këtë periudhë më datë 01.03.2019 u publikua një vendim për shkarkimin e gjyqtarit R.S. nga Gjykata Themelore në Ohër.

Me kërkesë të IDNJ nga data 08.04.2019 për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik me pyetjen: ***Sa është numri i procedurave të ngritura për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës të iniciuara në periudhën kohore 01.01.2019-31.03.2019 dhe në bazë të cilave dispozita të vlefshme ligjore janë iniciuar?*** nga ana e Këshillit Gjyqësor akoma nuk është pranuar përgjigje.

Këshilli Gjyqësor, kohë më parë, miratoi **Vendim me të cilin ia hoqi imunitetin gjyqtarit të Gjykatës Administrative** për shkak të zhvillimit papengesa të procedurës penale, **por nuk e aprovoi kërkesën për përcaktimin e masës paraburgim për gjyqtarin**, Këshilli Gjyqësor këtë komunikatë duhej ta arsyetonte në detaje para publikut, përkatësisht të sqaroj se për cilat shkaqe nuk është lejuar caktimi i paraburgimit të gjyqtarit³

Gjykata Supreme e RMV me shkresë ia ka dërguar aktvendimin Këshillit Gjyqësor me të cilin ankesa e Jordan Mitrovski hidhet poshtë si e pabazë, ndërsa konfirmohet aktvendimi i Këshillit Gjyqësor nga data 11.01.2018, me të cilin është konstatuar ushtrim joprofesional dhe i pandërgjegjshëm të funksionit gjyqtar të Jordan Mitrovski, si gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkup.

Krahas zgjedhjes së anëtarëve të rinj të Këshillit Gjyqësor, në bazë të të cilit ndryshoi përbërja e komisioneve për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, megjithatë nuk u respektua parimi i urgjencës së këtyre procedurave, veçanërisht që një pjesë e tyre janë procesuar që në muajin dhjetor të vitit 2017 nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve (i cili është suspenduar para një vit e gjysmë).

Parashtresa

Shkurt 2018 – prill 2019	
Numri i parashtresave të shqyrtuara	rreth 70

3 Instituti për të Drejtat e Njeriut konsideron se vendim për masën e sigurimit të prezencës – paraburgim mund të miratoj vetëm gjykata kompetente (dhe jo ndonjë organ tjetër)

Këshilli Gjyqësor në këtë periudhë i shqyrtoi parashtrirat dhe ankesat nga qytetarët dhe personat juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe për punën e gjykatave. **Megjithatë, numri më i madh i tyre u refuzua si të pabaza meqë paraqitësit në të njëjtat kanë prezantuar gjetje ankimore të cilat janë pjesë e procedurave gjyqësore, ndërsa një pjesë e vogël u revokuan si jo të plota. Një pjesë e madhe e parashtrirave refuzohen si të pabaza nëse procedura gjyqësore është në rrjedhë e sipër. Në rastet kur anëtarët e Këshillit Gjyqësor do të vendosin të sigurojnë të dhëna shtesë, si dhe të shqyrtojnë fakte plotësuese për veprimin e gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës në bazë të ndonjë parashtrirë, ata vendosin që atë parashtrirë ta shqyrtojnë në njërin nga mbledhjet e ardhshme, megjithatë nuk arsyetohet çdoherë kontinuiteti i këtyre procedurave, madje as ajo se cilat fakte shtesë janë konstatuar që të miratohet vendim përkatës nga ana e Këshillit Gjyqësor.**

Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor

Kuvendi, më datë 16.05.2019, e miratoi **Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor** i cili u harmonizua me Opinionin e Komisionit të Venecias përmes amendamenteve në procedurë parlamentare. Gjatë kësaj periudhe duhet të përfundojë procedura e dekretimit të tij dhe shpalljes në Gazetën Zyrtare si dhe hyrja në fuqi e të njëjtit.

Si ndryshime më të rëndësishme të cilat ishin edhe rekomandime nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, të cilat do të ndikojnë mbi punën e Këshillit Gjyqësor dhe me këtë edhe mbi sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit janë:

- Gjatë zgjedhjes së gjyqtarit në gjykatë themelore – intervista e kandidatëve për gjykatën themelore vlerësohet nga Këshilli Gjyqësor dhe notohet me më së shumti 10% nga numri i përgjithshëm i pikëve, duke i vlerësuar kompetencat e tyre personale dhe sociale.
- Përveç Ministrit të Drejtësisë edhe **Kryetari i Gjykatës Supreme nuk ka të drejtë vote.**
- Për realizimin e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve Këshilli Gjyqësor formon komision:

Komisioni për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve, anëtarët e të cilit i zgjedh Këshilli Gjyqësor përbëhet nga kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Kryetari i Komisionit për Zgjedhje, një anëtar dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa një anëtar dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga radhët e **përfaqësuesve të shoqatave dhe fondacioneve të cilat punojnë më shumë se pesë vjet në fushën e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.**

Para votimit të anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve, Këshilli në ueb-faqen e tij publikon thirrje për shoqatat dhe fondacionet që të nominojnë nga një kandidat për anëtar të Komisionit për Zgjedhje.

- Kërkesë të arsyetuar për ngritjen e procedurës për **përgjegjësi disiplinore** të anëtarit të Këshillit, deri te Këshilli Gjyqësor mund të paraqesin **më së paku 20 gjyqtarë ose çdo anëtar i Këshillit Gjyqësor me të drejtë vote.**

Instituti për të Drejtat e Njeriut do të vazhdoj në kontinuitet ta ndjek implementimin esencial të ligjeve dhe akteve nënligjore përmes punës së Këshillit Gjyqësor dhe organeve të tjera kompetente dhe të propozoj ndryshime nëse për një gjë të këtillë paraqitet nevoja.

Институтот за човекови права изготви мобилна апликација за следење на работата на Судскиот совет. Апликацијата може да ја преземете БЕСПЛАТНО на Google Play Store и на Apple Store под името „Судски совет под лупа“. Тука ќе ги најдете сите тековни информации и квартални извештаи изработени во рамките на проектот „Акција за поголема транспарентност, отчетност и ефективност на Судскиот совет на РМ“.

